

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegj i përbërë nga gjyqtarët Emine Mustafa kryetare e kolegjit dhe gjyqtarët Valdete Daka dhe Avdi Dinaj, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Minire Xhambazi, në çështjen penale kundër të akuzuarit E. S. nga Komuna e Mitrovicës, për shkak të veprës penale rrëmbimi 194 par.2 pika 2.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, në bashkim real me veprën penale nën pikën 1 të dispozitivit, kanosje nga neni 185 par.4 të KPRK në bashkim real me veprën penale nën pikën 1 e 2 të dispozitivit dhe lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të dispozitivit dhe lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK në bashkim real me veprën penale nën pikën 1,2 e 3 të dispozitivit, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të akuzuarit avokatit G.R. , paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Departamenti për Krime të Rënda P.nr.4/2016 datë 1.2.2016 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, PN.1.nr.190/2016 datë 29.1.2016, në seancën e mbajtur më 16.2.2016, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Me pranimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të mbrojtësit të të akuzuarit E.S., ndryshohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Departamenti për Krime të Rënda P.nr.4/2016 datë 1.2.2016 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, PN.1.nr.190/2016 datë 29.1.2016, ashtu që të akuzuarit i ndërpritet masa e paraburgimit dhe i akuzuari lëshohet menjëherë në liri.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Departamenti për Krime të Rënda P.nr.4/2016 datë 11.2.2016 i akuzuari E. S., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale rrëmbimi 194 par.2 pika 2.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, në bashkim real me veprën penale nën pikën 1 të dispozitivit, kanosje nga neni 185 par.4 të KPRK në bashkim real me veprën penale nën pikën 1 e 2 të dispozitivit dhe lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të dispozitivit dhe lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK në bashkim real me veprën penale nën pikën 1, 2 e 3 të dispozitivit, dhe është dënuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve dhe dënim me gjobë 500 (pesëqind) euro.

Pas shpalljes së aktgjykimit kjo gjykatë me aktvendim të posaqëm P.nr.4/2016 datë 1.2.2016 ia ka vazhduar masa e paraburgimit deri në plotëfuqishmërinë e aktgjykimit, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar, konform dispozitës së nenit 367 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 187 par.1 nënpar.2 pika 1.2.3 të KPRK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PN.1.nr. 190/2016 datë 29.1.2016, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit, avokat G. R., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 432 par.1 nënpar.1.2 dhe 4 të KPRK-së, me propozim që të akuzuarit t'i hiqet masa e paraburgimit.

Përgjigje ndaj kërkesës së mbrojtësit të të akuzuarit për mbrojtje të ligjshmërisë ka dhënë Prokurori i Shtetit, me prashtrësën KMLP.III.nr.10/16 datë 15.1.2016, me të cilën ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit i shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1, lidhur me nenin 436 par. 1 të KPPK, vlerësoi pretendimet e paraqitura në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Gjykata Supreme, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së mbrojtësit të të akuzuarit për mbrojtje të ligjshmërisë, vlerësoi se aktvendimet e kundërshtuara duhen ndryshuar dhe i akuzuari duhet liruar nga masa e paraburgimit, për arsye se atvendimet e kundërshtuara me kërkesë janë të paqëndrueshme, për çka me të drejt tërheq vërejtjen mbrojtësi. Gjykata e shkallës së parë vazhdimin e paraburgimit në bazë të nenit 187 par.1 nënpar.2 pika 1.2.3 të KPRK –së, e ka arsyetuar si vijon: “..., duke marrë parasysh peshën e veprave penale /rrethim personi dhe ate femer/ mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprave penale, duke i hedhur prej në fytyrë, kërcnimet e parreshtura kundër të dëmtuarës përmes rrjetit social, këmbëngulësia e tij për të kryer veprën penale, fakte që tregojnë këmbëngulësinë e të pandehurit në krerjen e veprave penale”

Sipas ligjit, masa e paraburgimit që caktohet respektivisht vazhdohet mbi bazën ligjore të nenit 187 par.1 nënpar.2 pika 1.2.3 të KPRK-së, ka të bëjë me ekzistimin e rrezikut të serishëm kriminal në anën e të pandehurit. Rrethanat konkrete, me rastin e caktimit-vazhdimin të paraburgimit mbi këtë bazë mund të jenë rrethana që kanë të bëjnë me kryerjen e veprës si recidivist, mënyrën e kryerjes, intervalin e shkurtër kohor në të cilin i pandehuri ka kryer shumë vepra penale, vetitë personale të të pandehurit, patologjinë e personalitetit, gjendjen shëndetësore si dhe faktorët socialë, kur i pandehuri nuk ka vendbanim të caktuar, është i papunë, është i prirë për bredhje, mjetet për jetesë i siguron me vepër penale etj.

Në rastin konkret, asnjë nga këto rrethana nuk janë vënë në pah nga gjykata që e ka vazhduar paraburgimin, por ato janë mjaftuar me parafrazim, pa dhënë arsye ligjore dhe logjike për përfundimet e veta, gjë që vazhdimin e paraburgimin e bën të paligjshëm. Konstatimi se i akuzuari do ta përsëriste veprën penale (po të ndodhej në liri), është një konstatim paushall dhe nuk është arsyetuar me asnjë provë . Mënyra e kryerjes, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale dhe pesha e veprës penale, në rastin konkret nuk e arsyetojnë fare përfundimin e gjykatave për drujtjen se mund të përsëritet vepra penale, ngase në shkresat e lëndës nuk ekziston asnjë provë bindëse e cila do ta vërtetonte një fakt të tillë , ngase nga shkresat e lëndës del se i akuzuari asnjëherë nuk ra në kundërshtim me

ligjin, apo është i evidentuar për ndonjë procedim penal, andaj sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk rezulton e bazuar druajtja për mundësinë e përsëritjes së veprës, siq janë cekur në aktvendimet e kundërshtuara.

Për këtë arsye, kolegji i kësaj Gjykate, konform nenit 438 par. 1 pika 1.1 të KPP, aprovoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.44/2016, më 16.2.2016

Procesmbajtësja,  
Minire Xhambazi

Kryetare e kolegjit,  
Emine Mustafa